



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Histori**

Lënda: HISTORIA E SHQIPËRISË GJATË PERIUDHËS OSMANE. PJ. II

<i>Pedagogu:</i>	Prof. Dr. Ferit Duka;
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (60 ore, 45 leksione dhe 15 seminare) 3/1
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Viti/ Semestri:</i>	II/II

Përshkrimi: Gjatë zhvillimit të kursit do të trajtohen çështje që lidhen me historinë shqiptare të fazës së fundit të periudhës osmane, fazë, e cila njihet ndryshe si *Rilindja Kombëtare Shqiptare* dhe rrok harkun kohor nga vitet 40 të shek. XIX deri në vitin 1912. Nëpërmjet leksioneve dhe seminareve, do të synohet që studentët jo vetëm të marrin informacionin e duhur, por edhe të nxiten për diskutime dhe analiza të pavarura rreth tematikës që do të shtjellohet. Në fokus do të jenë sidomos reformat e Perandorisë Osmane (Tanzimati) dhe shqiptarët, përmbajtja dhe tiparet e Rilindjes, zhvillimi i nacionalizmit shqiptar dhe programi i tij politik, vendi dhe roli i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në luftën dhe përpjekjet e shqiptarëve për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë dhe krijimin e shtetit kombëtar të pavarur, si dhe ngjarjet, proceset dhe dukuritë dhe rrethanat që përgatitën shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Temat e leksioneve:

1. Tanzimati dhe shqiptarët; shpresa dhe zhgënjime, tensione dhe konflikte përballë reformave osmane.
2. Fillimet e Rilindjes Kombëtare, përmbajtja dhe tiparet e saj. Sfondi politik, shoqëror, kulturor dhe ekonomik i Rilindjes.
3. Pionierët e Rilindjes: Naum Veqilharxhi, vepra dhe idetë e tij për zgjimin kombëtar të shqiptarëve.
4. Zhvillime të reja në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare gjatë viteve 1850-1870: ndërthurja e aspekteve kulturore dhe politike.
5. Lidhja Shqiptare e Prizrenit (vitet 1878-1881) dhe platforma e saj politike. Lufta për ruajtjen e tërësisë tokësore dhe autonominë e Shqipërisë.
6. Fuqizimi i përpjekjeve për afirmim kombëtar të shqiptarëve nëpërmjet zhvillimit të arsimit dhe të kulturës kombëtare (v. 80-90 të shek. XIX). Veprimtaria kulturore e shoqërive patriotike. Lufta për shkollën shqipe.
7. Riaktivizimi i projektit politik kombëtar: Lidhja Shqiptare e Pejës (1899).
8. Lëvizja Kombëtare Shqiptare me taktika dhe strategji të reja: Komitetet për Lirinë e Shqipërisë dhe çetat patriotike.
9. Revolucioni i Turqve të Rinj (Xhonturqve) dhe shqiptarët. Ballafaqimi i nacionalistëve shqiptarë me politikën qendëruese panosmaniste të Turqve të Rinj.
10. Gjallërimi i lëvizjes kulturore dhe arsimore: klubet kombëtare shqiptare dhe veprimtaria e tyre patriotike.
11. Avancimi i përpjekjeve për arsimin dhe shkollën shqipe: Kongresi i Manastirit. Kongreset e Dibrës dhe Elbasanit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



12. Acarimi i marrëdhënieve shqiptaro-osmane. Kërkesat me karakter kombëtar si pjesë e luftës politike të elitës shqiptare (vitet 1908-1910).
13. Diaspora shqiptare dhe Lëvizja Kombëtare: roli dhe kontributi i bashkësive shqiptare jashtë atdheut në emancipimin politik kombëtar të shqiptarëve.
14. Çështja kombëtare dhe feja gjatë Rilindjes: qëndrimi i nacionalistëve shqiptarë ndaj fesë dhe komuniteteve fetare në Shqipëri.
15. Shqiptarët, faktor i fuqishëm i luftës çlirimtare në Ballkan: kryengritjet kundërosmane të viteve 1910-1912. Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI: 70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times Neë Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. Belegu, Xhafer. *Lidhja e Prizrenit dhe veprimet e saj (1878-1881)*. (Tiranë: 1939).
2. Frashëri, Kristo. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881)*. (Tiranë: Toena, 1997).

Literatura plotësuese:

1. Gawrych, George. *Gjysmëhëna dhe shqiponja: sundimi ottoman, islamizmi dhe shqiptarët (1874-1913)*. (Tiranë: Bota shqiptare, 2007).
2. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II. (Tiranë: TOENA, 2002).
3. Jacques, Edwin. *Shqiptarët: historia e popullit shqiptar nga lashtësia, deri në ditët e sotme*. (Tiranë: Kartë e pendë, 1995).
4. Malcolm, Noel. *Kosova: një histori e shkurtër*. (Prishtinë-Tiranë: Koha-Shtëpia e Librit, 2001).
5. Skëndi, Stavro. *Zgjimi kombëtar shqiptar*. (Tiranë: Phoenix, 2000).
6. Joseph Swire. *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*. (Tiranë: Dituria, 2005).
7. Zavalani, Tajar. *Histori e Shqipnis*. (Tiranë: Phoenix, 1998).